

Prioritetet për komunën e Dibrës

1. Unaza e qytetit

Rruga e Arbërit në territorin e Shqipërisë mbaron së shpejti, dhe është e nevojshme funksionalizimi i saj në pjesën e Maqedonisë.

Gjendja aktuale është që i gjithë fluksi i automjeteve që kalon nga Bllata duhet të kalojë mes përmes qytetit të Dibrës, në një rrugë të ngushtë dhe pa standarde për një rrugë ndërkombëtare.

Jetike është ndërtimi i Unazës së Dibrës nga Bllata deri në dalje të Dibrës. Kjo unazë jo veçse do të rregullonte trafikun, por në të njëjtën kohë do të jepte një impuls zhvillimor në fshatrat e braktisura të Dibrës. Unaza parashikon të lidhë në mënyrë direkte njëra me tjetrën shumicën e fshatrava kufitare.

2. Largimi i largpërçuesve nga vendbanimet

Largpërçuesit në zonën urbane të qytetit duhet të dislokohen për arsye se janë rrezik i vazhdueshëm për qindra banorë të lagjes Venec 1. Kostoja e dislokimit është e madhe, por ELEM ka buxhet të paraparë për raste të ngjashme dhe jeta e çdo qytetari vlen më shumë se çdo kosto tjetër.

3. Institucionalizimi i Festivalit të teatrove shqiptare

Festivali i teatrove shqiptare, tash pas 20 edicioneve, duhet të jetë festival i institucionalizuar dhe i përhershëm, me buxhet të paracaktuar duke mos u trajtuar si eveniment që financohet vit pas viti.

4. Hapja e terminalit doganor në Bllatë

5. Sistemi i vaditjes së tokës bujqësore

Rivitalizimi i sistemit të ujitjes është i domosdoshëm për bujqësinë dibrane. Uji nga liqeni i Dibrës duhet të përdoret për vaditjen e fushës së Dibrës. Pas ndërtimit të sistemit të ujitjes, është e nevojshme krijimi i një ndërmarrje efikase komunale për menaxhim me sistemin e vaditjes.

6. Zgjidhja e problemit të ujit të pijshëm

Dibra është ndër qytetet me humbje më të madhe në rrjet të ujit të pijshëm. Nevojitet sanimi i gjithë rrjetit nga burimi deri në çdo përdorues privat. Gjithashtu nevojitet rritja e kapacitetit të

rezervuarit në posedim të “NPK Standart” Dibër. Nën udhëheqjen tonë, do të ndodhë si sanimi ashtu edhe rritja e kapacitetit të rezervuarit.

7. Zgjidhja e problemit të ndotjes së liqenit

Në bashkëpunim me Komunën Mavrovë dhe Rostushë do të ndërpritet hudhja e mbeturinave në Radike dhe liqe. Ndërkohë Komuna Dibër do të mirëmbajë vazhdimisht bregun e liqenit dhe të ndaloj deponitë e egra. Liqeni do të pyllëzohet pas dekadave degradimi të vazhdueshëm.

8. Hamami i vjetër - Muze historik/etnografik i Dibrës

Dibra është ndër të vetmet qytete pa muze historik dhe etnografik. Hamami i Dibrës do të shndërrohet në një muze të përhershëm të qytetit dhe të konceptohet si një ambient ku do të ekspozohen ngjarje historike por edhe mjete nga jeta e përditshme, familjare dhe ekonomike e dibranëve.

9. Dibra qytet me guidë turistike të integruar

Ne do të bëjmë inkurajimin dhe licencimin e guidave turistike që do të ngërthejnë në vete pika atraktive të turizmit malor, liqenor dhe kulturor. Do të ketë lehtësime për çdo biznes që tenton të krijoj kamp turistik apo shërbime të tjera për krijimin e një guide që do tërheqë turistë gjatë gjithë vitit.